



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 217

Tiranë – E premte, 6 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 154/2014 datë 27.11.2014	Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit	12899
Ligj nr. 177/2014 datë 18.12.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	12909
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 17, datë 27.11.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1468, datë 26.6.2006 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia".....	12911
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë & ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 31.12.2014	Për të drejtat, detyrat, mandatin, mënyrën e zgjedhjes dhe funksionimit të bordeve në shkollat publike të arsimit profesional	12911



LIGJ
Nr. 154/2014

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KONTROLLIT TË
LARTË TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81, 83, pika 1, dhe 162 deri në 165 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Erion Braçe,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat që kanë të bëjnë me organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Auditim” nënkupton veprimtarinë e auditimit, të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili përfshin auditimin e përputhshmërisë, auditimin financiar, auditimin e performancës, auditimin e IT-së, si dhe auditimin e kombinuar të tyre.

Në këtë ligj termi “auditim” ka të njëjtin kuptim me termin “kontroll” të përdorur në nenet 162, pika 1, 163 dhe 164, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

2. “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

3. “Auditim i IT-së” nënkupton një ekzaminim të zbatimit të sistemeve IT për të siguruar që ato përmbushin nevojat e subjektit të audituar, pa komprometuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së subjektit të audituar.

4. “Auditimi i performancës” ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe përfshin:

a) auditimin e ekonomicitetit, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij.

b) auditimin e efikasitetit, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë.

c) auditimin e efektivitetit, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.

5. “Auditim i përputhshmërisë” nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.

6. “Auditim i rregullshmërisë” përfshin:

a) verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare, si dhe shprehjen e mendimeve për pasqyrat financiare;

b) verifikimin e përgjegjësisë financiare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;

c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

ç) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm;



d) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, dhe

dh) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

7. “Auditues shtetëror” është nëpunës i Kontrollit të Lartë të Shtetit që kryen aktivitete të auditimit (të jashtëm) të sektorit publik.

8. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

9. “Fonde publike” janë të gjitha fondet, përfshirë edhe fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë, kur me ligj të veçantë nuk është parashikuar ndryshe, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen e shpenzohen nga njësitë e sektorit publik dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë e sektorit publik.

10. “Qeverisje e përgjithshme” është tërësia e njësisë të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

11. “Fond special” është fondi i krijuar me ligj, i cili ka si burime të ardhurat e krijuara me ligj, që përdoren vetëm për financimin e funksioneve apo të veprimtarive të veçanta të qeverisjes qendrore apo vendore.

12. “Njësi të qeverisjes qendrore” janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, si dhe ato të krijuara me ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore.

13. “Njësi të qeverisjes vendore” janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.

14. “Standarde të auditimit” janë një grup konceptesh, parimesh udhëzuese, procedurash dhe metodash, tek të cilat organi auditues bazohet në kryerjen e auditimit.

15. “Subjekte të audituara” janë të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, organet e pushtetit vendor, institucionet e tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucionet

e pavarura e shoqëritë tregtare apo të çdo forme tjetër, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

16. “Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit” (INTOSAI) përfshin institucionet supreme të auditimit të shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila ka si funksion kryesor nxjerrjen e metodave dhe standardeve të auditimit dhe ofrimin e trajnimeve ndaj institucioneve të auditimit publik.

17. “Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit” (EUROSAI) është një organizatë e pavarur, jopolitike, e cila promovon bashkëpunimin dhe nxit shkëmbimin e ideve, eksperiencave dhe teknikave ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit.

18. “Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve” (IFAC) është një organizatë ndërkombëtare, e cila ka për mision dhënien e ndihmesës në zhvillimin, adoptimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 4 Statusi i institucionit

K Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i pavarur, i cili i ushtron kompetencat e tij duke iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit është një organ i depolitizuar dhe i departizuar.

Neni 5 Selia, stema dhe vula

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka selinë në Tiranë.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka stemën dhe vulën e tij, që përbëhet nga një kombinim ndërmjet stemës shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe vitit të tij të krijimit.

Neni 6 Fusha e veprimtimit

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.



2. Auditimi mbulon fushat e përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t.

Neni 7 Buxheti

1. Buxheti i Kontrollit të Lartë të Shtetit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin pasqyrohet si institucion i veçantë.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit propozon çdo vit projektbuxhetin e tij në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, i cili e shqyrton dhe e paraqet për miratim në Kuvend, si pjesë integrale të Buxhetit të Shtetit.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e tij, të miratuar nga Kuvendi.

4. Kontrolli i Lartë i Shtetit përgatit çdo vit llogaritë e tij financiare, në përputhje me legjislacionin mbi buxhetin. Llogaritë auditohen nga një grup audituesish të pavarur, të përzgjedhur nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe të miratuar nga Kuvendi. Ky grup audituesish raporton për veprimtarinë e tij në Kuvend.

5. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë të përdorë të ardhurat dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare dhe botimet e tij.

Neni 8 Bashkëpunimi

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, bashkëpunon me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo ndërkombëtare.

2. Bashkëpunimi nënkupton anëtarësimin, pjesëmarrjen në formë të përshtatshme për auditimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, ku në çdo rast Kontrolli i Lartë i Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e Republikës së Shqipërisë.

KREU II KOMPETENCAT, TË DREJTAT DHE DETYRAT

Neni 9 Plani i auditimeve

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit vendos në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e veprimtarisë së tij.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë përcaktimit të planit të tij të auditimeve, mund të marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga njësitë e tjera të qeverisjes së përgjithshme.

Neni 10 Kompetencat

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij, ka për kompetencë:

a) auditimin e zbatimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë llogaritë vjetore të buxhetit;

b) auditimin e mbledhjes së të ardhurave publike;

c) auditimin e përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

ç) auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e opinionit për to;

d) auditimin e sistemeve të auditimit të brendshëm të sektorit publik;

dh) auditimin e përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Europian ose organizata të tjera ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me ligj të veçantë;

e) auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;

ë) auditimin, me qëllim mbrojtjen e interesave publikë, në veprimtaritë apo sektorët e rregulluar me kontrata koncesionare;

f) auditimin e partive politike, enteve publike apo shoqatave për fondet që u janë akorduar atyre nga Buxheti i Shtetit;



g) auditimin e subjekteve të tjera, të përcaktuara në ligje të veçanta.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit, jep opinionin për raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar, i cili përfshin edhe vlerësimin e bërë, bazuar në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 11 Auditimi financiar

Në auditimet financiare, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Neni 12 Auditimi i përputhshmërisë

Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë:

a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Neni 13 Auditimi i performancës

1. Në auditimet e performancës, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vlerësojë nëse programet, organizimi i punës dhe proceseve, veprimtaritë dhe sistemet e menaxhimit të subjekteve të sektorit publik operojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit është i autorizuar të kryejë auditimin e performancës në çdo moment që e konsideron të nevojshëm.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit publikon raportet e tij mbi auditimin e performancës.

Neni 14 Auditimi i teknologjisë së informacionit

Në auditimet e IT-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan

integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive dhe përdor burimet në mënyrë efikente.

Neni 15 Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:

a) të informojë drejtuesit e njërive të audituara apo institucioneve më të larta për shkeljet e akteve normative, me pasojë dëme materiale, dhe t'u rekomandojë atyre korrigjimin / rregullimin / ndryshimin e akteve ligjore;

b) të informojë drejtuesit e njërive të audituara apo organet e kompetencës mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t'u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;

c) t'u rekomandojë drejtuesve të njërive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;

ç) t'u përcjellë organeve të posaçme të shqyrtimit administrativ, sipas fushave përkatëse të kompetencës, gjetjet mbi shkeljet që janë objekt shqyrtimi, së bashku me dokumentet përkatëse të auditimit;

d) t'i sigurohen nga subjektet e audituara kushtet, vendi i punës dhe mjetet e nevojshme logjistike për kryerjen e veprimtarisë audituese në rastet kur misionet e auditimit zhvillohen në mjediset e tyre;

dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake;

e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;

ë) në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, t'u kërkojë personave juridikë, ku shteti disponon me shumë se 50 për qind të aksioneve ose kur huat, kreditë dhe



detyrimet e tyre garantohen nga shteti, të cilët posedojnë dokumente shkresore apo elektronike që konsiderohen të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit, që t'i paraqesin ato, sipas kërkesës, tek audituesit përgjegjës;

f) t'u kërkojë autoriteteve publike, të cilat kanë kompetenca në fushën e kontrollit financiar, kontrollit fiskal, si dhe kontrollit apo mbikëqyrjes në fusha të tjera, që t'i japin përparësi dhënies nga ana e tyre të ndihmës në kryerjen e proceseve të auditimeve të veçanta të ndërmarrja nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili në këto raste u drejtohet atyre me një kërkesë të veçantë.

g) të kërkojë nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë t'i vihen në dispozicion, brenda një afati të arsyeshëm, të dhënat në lidhje me llogaritë e institucioneve të qeverisjes qendrore, organeve të pushtetit vendor, institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucioneve të pavarura, si dhe të shoqërive tregtare apo të çdo forme tjetër organizimi shoqëror, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;

gj) t'u drejtohet organeve të ndjekjes penale në rastet kur ndjekja e mëtejshme e zbulimeve nga auditimi është kompetencë e tyre;

h) t'i drejtohet gjykatës me padi;

i) t'i propozojë inspektimit financiar dhe njësitë të auditimit të brendshëm publik të kryejnë inspektime dhe auditime brenda kompetencave të tyre;

j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;

k) t'u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

l) t'i propozojë Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat ose ndonjë komisioni tjetër përkatës të Kuvendit që të marrin në shqyrtim raporte të veçanta të auditimit.

Neni 16

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e duhura.

2. Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij, dhe pa cenuar të drejtën për të kryer vetë auditimet, Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të përdorë gjetjet e auditimeve të kryera nga organe të tjera audituese.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare të auditimit.

Neni 17

Konsultimi dhe dhënia e opinionëve

1. Për çështje që kanë të bëjnë me hartimin e një projektligji që lidhet me funksionin, veprimtarinë, detyrat dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, organet shtetërore konsultohen paraprakisht me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet dhe veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit jep opinionet e tij, si dhe bën propozime për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në fushat brenda kompetencave të tij.

Neni 18

Revokimi dhe ndryshimi i akteve

Në rastet kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit vëren mospërputhje të akteve ligjore ose nënligjore me ligjet bazë apo me njëri-tjetrin, ai ka të drejtë t'u rekomandojë organeve kompetente ndryshimin, revokimin apo shfuqizimin e tyre ose t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.



KREU III
KRYETARI I KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT

Neni 19

Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit drejtohet dhe përfaqësohet nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, për një mandat shtatëvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

3. Paga e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është e barabartë me atë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 20

Kushtet për t'u zgjedhur

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) ka arsim të lartë në ekonomi, financë ose drejtësi;
- b) përvojë profesionale në çështje financiare;
- c) ka kualifikime të larta profesionale dhe përvojë pune në profesion jo më pak se 10 vjet;
- ç) gëzon integritet të lartë moral dhe profesional;
- d) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 21

Papajtueshmëritë e funksionit

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur në organet e pushtetit vendor, apo në organet e ndonjë partie ose organizate politike.

Ai nuk mund të kryejë detyra me ose pa shpërblim në subjektet e tjera publike, private apo jofitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, botimeve dhe veprimtarive kulturore e sportive, me kusht që këto aktivitete nuk dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe nuk cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit fillon detyrën pasi bën betimin përpara Kuvendit.

3. Formula e betimit është: “Betohe se do t'i qëndroj kurdoherë besnik zbatimit të Kushtetutës dhe ligjeve të tjera të vendit, mbrojtjes së interesave të Shqipërisë dhe të drejtave e lirive themelore të shtetasve, dhe do të përmbush me nder, ndërgjegje dhe drejtësi detyrat dhe kompetencat e mia si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Neni 22

Imuniteti

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij.

3. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet liria në çfarëdo formë apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Gjykatës Kushtetuese, përveçse nëse kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi.

Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatën Kushtetuese, e cila, në qoftë se nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Neni 23

Mbarimi i mandatit dhe shkarkimi

1. Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur:

- a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë;
- b) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- c) nuk paraqitet në detyrë për shkaqe të paarsyeshme;
- ç) jep dorëheqjen;
- d) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- dh) mbush moshën e pensionit;
- e) vdes.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të shkarkohet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, kur:

- a) shkel Kushtetutën ose shkel rëndë ligjin gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- b) cilësohet nga gjykata me vendim të formës së prerë si i paaftë për të kryer detyrat e tij;
- c) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;



ç) kryen akte ose sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;

d) zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.

3. Në rast se vendi i kryetarit mbetet vakant, Presidenti, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit kandidaturën e re. Kuvendi zgjedh Kryetarin e KLSH-së brenda 15 ditëve nga paraqitja e kandidaturës.

Neni 24

Vazhdimësia pas përfundimit të mandatit

1. Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas përcaktimit të nenit 19 të këtij ligji, ky i fundit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

2. Kryetari i KLSH-së rikthehet në detyrën e mëparshme dhe, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.

Neni 25

Përgjegjësitë

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përgjegjës dhe vendos për:

a) politikat dhe strategjitë e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

b) planin vjetor të auditimit dhe autorizimet për kryerje të auditimit jashtë planit fillestar;

c) manualët dhe standardet e auditimit;

ç) marrjen e vendimeve për raportet e auditimit, për masat administrative dhe civile, që u rekomandohen subjekteve pas përfundimit të auditimit;

d) dërgimin e raporteve të auditimit në institucionet shtetërore etj.;

dh) materialet që duhet të dërgohen në prokurori;

e) çështjet, për të cilat do t'i drejtohet gjykatës me padi;

ë) strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

f) për kompetencat dhe detyrat e njëjësive organizative;

g) strukturën e pagave dhe shpërblimeve të personelit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

gj) për rregullat dhe udhëzimet, të cilave duhet t'u përmbahet personeli;

h) për rregulloret e brendshme apo manualin përkatës se si audituesit duhet të trajtojnë rastet e dyshimit për mashtrim dhe korrupsion;

i) për nëpunësin e autorizuar prej tij, i cili mund të përfaqësojë Kontrollin e Lartë të Shtetit në marrëdhënie me të tretë;

j) përcaktimin e orarit dhe ditëve të punës për punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe në raste të veçanta, ndryshimin e tyre në përputhje me Kodin e Punës;

k) për çështje të tjera të specifikuar me ligj.

KREU IV

E DREJTA E DISPONIMIT TË DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONIT

Neni 26

Aksesi në dokumentet zyrtare

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk mund t'u kërkojë dokumente apo informacione dhe as të shkojë fizikisht te subjekte, të cilat nuk janë subjekte të audituara në kuptim të neneve 3 dhe 10 të këtij ligji. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk mund të ndërhyjë në vetëdeklarimin e subjekteve tatimore, por jep rekomandime për sa i përket vlerësimit dhe rivlerësimit të tyre.

Neni 27

Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekretit shtetëror

1. Në rast se Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, përballet me dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike dhe çdo informacion tjetër që përbën sekret shtetëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror,



Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të ruajë konfidencialitetin. Në këto raste KLSH-ja vë në dijeni autoritetet e interesuara kompetente.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve të siguruar për shkak të detyrës, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 28

Auditimi i veprimtarive “sekret shtetëror”

1. Veprimtaritë që përbëjnë sekret shtetëror, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, duhet të auditohen nga auditues të autorizuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët duhet të kenë certifikatën e sigurisë, të lëshuar nga institucioni përkatës.

2. Raportimi i këtyre auditimeve bëhet në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe/ose në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit.

KREU V

RAPORTIMI I AUDITIMIT

Neni 29

Komente dhe shpjegime mbi projekt-raportin

1. Përpara nxjerrjes së raportit përfundimtar të auditimit, subjektit të audituar duhet t'i krijohet gjithnjë mundësia për të komentuar mbi projekt-raportin.

2. Komentet dhe shpjegimet e bëra i dërgohen Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 1 muaji nga data e marrjes së projekt-raportit. Këto komente dhe qëndrimi i audituesve ndaj tyre duhet të pasqyrohen në raportin përfundimtar.

Neni 30

Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit

1. Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njofimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Neni 31

Raportimi në Kuvend

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:
 - a) raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
 - b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
 - c) informacion për rezultatet e auditimeve sa herë që kërkohet nga Kuvendi;
 - ç) raporte përfundimtare të auditimit kur çmohet e nevojshme nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit apo kur kërkohen nga Kuvendi.
2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund t'i kërkojë Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, apo ndonjë komisioni tjetër të Kuvendit, që të dëgjohet dhe të raportojë, për çështje që ai i çmon si të rëndësishme në funksion të veprimtarisë së tij.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi aktivitetet e tij brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Neni 32

Paraqitja e raporteve të auditimit

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ia paraqet raportet përkatëse të auditimit subjektit të audituar, duke përfshirë edhe rastet kur ato i paraqiten Kuvendit.
2. Kryetari vendos nëse është e nevojshme t'i paraqiten këto raporte edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare apo Ministrit të Financave.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet t'i paraqesë Këshillit të Ministrave, autoriteteve të tjera shtetërore, organizatave jofitimprurëse, me të cilat KLSH-ja ka marrëveshje bashkëpunimi, publikut dhe palëve të tjera të interesuara, kur ai e gjykon të nevojshme dhe në interes të shtetit dhe të publikut, raporte, studime dhe materiale të tjera që kanë të bëjnë me Këshillin e Ministrave, ministrinë dhe institucione të tjera qendrore.

Neni 33

Buletini dhe botimet

1. Në funksion të detyrave të tij informuese dhe qëllimit për shkëmbimin e përvojës, Kontrolli i Lartë i Shtetit boton rregullisht një buletin, i cili duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:



a) raportet përfundimtare dhe vjetore të auditimit;

b) konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve me rëndësi të veçantë;

c) llogaritë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfshirë edhe opinionin e audituesve për to.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në varësi të qëllimit dhe detyrave të mësipërme, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, universitare dhe të shoqërisë civile, mund të angazhohet në organizimin e analizave të hapura vjetore të punës, konferencave shkencore në fushën e auditimit publik dhe menaxhimit financiar. Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të angazhohet në botimin e revistave shkencore dhe profesionale, përkthime, botime, shpërndarje të publikimeve të organizatave ndërkombëtare të auditimit (të jashtëm), të institucioneve të tjera homologe që konsiderohen me interes.

Neni 34

Transparenca dhe informimi i publikut

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet:

a) publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH-ja në Kuvendin e Shqipërisë;

b) publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike;

c) konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media;

ç) publikimit të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së;

me përjashtim të informacioneve dhe materialeve, të cilat përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale, siç parashikohet dhe në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.

KREU VI

ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE STATUSI I PUNONJËSVE

Neni 35

Organizimi strukturor

1. Organizimi, kompetencat, detyrat dhe zhvillimi i veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit bëhen në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloren e miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në funksion të qëllimeve të veprimtarisë së tij audituese, ka të drejtën e ngritjes së strukturave në nivel vendor.

Neni 36

Papajtueshmëritë në funksionet audituese

1. Punonjësit që ushtrojnë funksione audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk lejohet të marrin një mandat politik dhe as të jenë anëtarë aktivë të ndonjë organizate apo partie politike, si dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose me karakter tregtar. Përfshihen nga kufizimi mësimdhënia, botimet dhe veprimtari kulturore apo sportive, me kusht që këto aktivitete të mos dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe të mos cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nxjerr rregulla në lidhje me rastet e papajtueshmërive me funksionet audituese.

3. Në rast se konstatohen papajtueshmëri në kryerjen e detyrës me pozicionin përkatës të punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndaj punonjësit fillon procedimi disiplinor.

Neni 37

Statusi i punonjësve dhe rregullat etike

1. Administrimi i shërbimit civil në Kontrollin e Lartë të Shtetit, rekrutimi, ngritja në detyrë, lëvizja paralele, vlerësimi, transferimi, lrimi pezullimi, si dhe masat e tjera disiplinore, për punonjësit e këtij institucioni, bëhen në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

2. Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje përcaktimet e bëra në këtë ligj, legjislacionin mbi shërbimin civil, rregulloren e brendshme të institucionit, standardet e auditimit dhe Kodin e Etikës.

Neni 38

Realizimi i funksioneve audituese dhe mbështetëse

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit realizon funksionet e tij nëpërmjet ushtrimit të detyrave të auditimit. Në veprimtarinë e tyre audituesit mbështeten nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të shërbimeve mbështetëse.

2. Audituesit dhe nëpunësit e tjerë të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë nëpunës civilë. Marrëdhëniet



e punës të punonjësve të tjerë mbështetës rregullohen nga Kodi i Punës.

Neni 39

Trajnimet profesionale

1. Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzojnë të drejtën për t'u trajnuar profesionalisht, sipas planifikimeve të bëra nga institucioni, në përputhje me nevojat e evidentuara.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe certifikimit, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit, në bashkëpunim me ASPA-n, me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo ndërkombëtare.

Neni 40

Ekspertët e përkohshëm të jashtëm

1. Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit dhe në varësi të nevojave, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të kontrakttojë përkohësisht ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj.

2. Ekspertët e përkohshëm të jashtëm janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që sigurojnë gjatë ekspertimit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror. Ata duhet të respektojnë Kodin e Etikës dhe rregulloren e brendshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3. Shpenzimet e ekspertëve përballohen nga buxheti i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit miraton me vendim paraprakisht rregullat për përzgjedhjen dhe mënyrën e pagesës së tyre. Vendimi publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 41

Parimet e detyrës së audituesve shtetërorë dhe ekspertëve të jashtëm

1. Në ushtrimin e detyrës së tyre, audituesit shtetërorë dhe ekspertët e jashtëm, të kontraktuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duhet të jenë të pavarur dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë kufizimi apo presioni në lidhje me opinionet e tyre.

2. Marrëdhënia profesionale ndërmjet tyre dhe subjekteve të audituara duhet të bazohet në ndershmërinë, integritetin, korrektësinë, konfidencialitetin dhe pavarësinë nga subjekti i audituar, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

3. Gjatë kryerjes së detyrave dhe kompetencave të tyre, audituesit shtetërorë dhe ekspertët e jashtëm nuk duhet të kërkojnë e as të pranojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për vete ose për personat e tjerë, dhurata apo përfitime të tjera.

4. Përgjegjësia disiplinore e audituesve shtetërorë rregullohet nga legjislacioni mbi shërbimin civil, Kodi i Etikës dhe rregullorja e brendshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

Miratimi i rregulloreve, manualeve, udhëzimeve dhe Kodit të Etikës

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ngarkohet që, brenda 3 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij ligji, të miratojë rregulloret, manualët, vendimet, udhëzimet dhe Kodin e Etikës, sipas neneve 25, 37 dhe 40 të këtij ligji.

Neni 43

Shfuqizime

Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 44

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2015.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 27.11.2014



LIGJ
Nr. 177/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8588, DATË 15.3.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS SË LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, shkronja “b”, në nënndarjen “ii” hiqen fjalët “dhe docent” dhe fjalët “ose drejtor”.

2. Në pikën 2, shkronja “a”, nënndarja “v” ndryshohet si më poshtë:

“v) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8, si dhe vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;”.

3. Pas nënndarjes “vi” shtohen nënndarjet “vii” dhe “viii” me këtë përmbajtje:

“vii) gëzimit të një integriteti të lartë moral;

viii) transparencës së plotë dhe të dokumentuar të të gjitha të ardhurave dhe asetëve, si dhe pagimi i të gjitha detyrimeve tatimore, bazuar në dokumentacionin zyrtar të institucioneve shtetërore përgjegjëse në fushën e tatimeve, regjistrimit të interesave privatë dhe deklarimit e kontrollit të pasurive, konfliktit të interesit.”.

4. Në shkronjën “b”, nënndarjet “i” dhe “ii” ndryshohen si më poshtë:

“i) përbërjes së trupës gjyqësore, në momentin e emërimit të kandidatit, duke synuar balancën ndërmjet përvojave personale të anëtarëve, me qëllim funksionimin e kolegeve të specializuara, sipas fushave të së drejtës dhe përmbushjen e rolit kushtetues të Gjykatës së Lartë për njësimin ose

ndryshimin e praktikës gjyqësore përmes vendimeve unifikuese;

ii) përbërjes së trupës gjyqësore, në momentin e emërimit të kandidatit, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit, me synim arritjen e një balance sa më të drejtë gjinore.”.

Neni 2

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Këshilli për Emërimet në Gjykatën e Lartë

1. Në funksion të verifikimit të përmbushjes nga kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë, të kushteve ligjore dhe kriterëve objektive shtesë, si dhe renditjes së tyre, krijohet Këshilli për Emërimet në Gjykatën e Lartë, si organ këshillimor për Presidentin e Republikës.

2. Këshilli për Emërimet përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, i zgjedhur nga trupa e anëtarëve të kësaj gjykate.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë është Kryetar i Këshillit për Emërimet. Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet administratës së kësaj gjykate, krijon kushtet e punës për veprimtarinë e këshillit, si dhe për dokumentimin e kësaj veprimtarie.

4. Mënyra e funksionimit të Këshillit për Emërimet rregullohet nëpërmjet një rregulloreje të hartuar dhe miratuar prej tij.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët “në nenet 4 dhe 4/1 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “në nenet 4 dhe 4/2 të këtij ligji”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Presidenti i Republikës, brenda 2 javëve nga marrja e njoftimit nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, njofton publikisht në faqen zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve, duke kërkuar paraqitjen e kërkesës individuale, dokumentacionin e nevojshëm për vërtetimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 3, si



dhe afatin, brenda të cilit subjektet e interesuara duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin për t'u përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, sipas pikës 4 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret mbledhjen e Këshillit për Emërimet për të shqyrtuar plotësimin e kushteve ligjore dhe të kriterëve objektive dhe shtesë të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë.

Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.

Mbledhja e Këshillit për Emërimet zhvillohet brenda 7 ditëve nga dita e thirrjes së saj.

Dosjet e kandidatëve, me kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, të paraqitur nga kandidatët, i vihen në dispozicion Këshillit për Emërimet nga institucioni i Presidentit të Republikës.”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Këshilli për Emërimet, pasi shqyrton dokumentacionin për secilin kandidat, brenda 10 ditëve harton një raport me shkrim, ku analizohet plotësimi i kushteve ligjore dhe kriterëve objektive dhe shtesë për secilin prej tyre.

Për kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj, Këshilli për Emërimet bën renditjen e tyre mbi bazën e vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kushteve dhe kriterëve, të parashikuara nga neni 3 i këtij ligji.

Si rregull, raporti miratohet me konsensus. Nëse nuk arrihet konsensusi, raporti miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit për Emërimet.”.

5. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Raporti i Këshillit për Emërimet i paraqitet Presidentit të Republikës, i cili e publikon në faqen zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës.”.

Neni 4

Neni 4/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4/1

Marrja e të dhënave dhe informacioneve zyrtare

1. Presidenti i Republikës, përveç raportit të Këshillit për Emërimet dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë kandidatët, mund të kërkojë të dhëna ose informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror, përfshirë edhe informacione konfidenciale, në lidhje me kandidatët.

2. Këto akte bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t'i vihen në dispozicion kandidatit, mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.”.

Neni 5

Pas nenit 4/1 shtohen nenet 4/2 dhe 4/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/2

Procesi i bashkëpunimit

Presidenti i Republikës, bazuar në raportin e Këshillit për Emërimet dhe dosjen e secilit kandidat, zhvillon konsultime me kryetarët e grupeve parlamentare në Kuvend për përzgjedhjen e kandidatëve. Procesi i konsultimit synon të garantojë një përzgjedhje të përshtatshme dhe sa më konsensuale mes kandidaturave që plotësojnë kushtet ligjore dhe kriteret objektive dhe shtesë, duke u bazuar në meritën dhe integritetin e tyre, në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, për të siguruar një përbërje cilësore dhe të përshtatshme të Gjykatës së Lartë.

Neni 4/3

Dekreti i emërimit

1. Dekreti i Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë publikohet në faqen zyrtare të Presidentit të Republikës dhe i përcillet menjëherë Kuvendit, i cili vijon procedurat, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.



2. Dekreti i Presidentit duhet të jetë i arsyetuar dhe të përcaktojë qartësisht arsyet e përzgjedhjes së kandidatit fitues.”.

Neni 6

Në nenin 31, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Për të gjitha problemet e tjera që nuk gjejnë zgjidhje në këtë ligj, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 18.12.2014

UDHËZIM
Nr. 17, datë 27.11.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË
UDHËZIMIN NR. 1468, DATË 26.6.2006
"PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 223,
DATË 19.4.2006 "PËR PAGESËN E TË
ARDHURËS NGA PAPANËSIA"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia", ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1468, datë 26.6.2006 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia" bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pika 13 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"E ardhura nga papunësia është mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë të marrë këtë të ardhur. Paga jepet një herë në muaj pranë bankës, pasi personi përfitues të jetë

paraqitur në zyrën e punësimit. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, përkundrejt paraqitjes në bankë të dokumentit të identifikimit ose kartës së debitit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

UDHËZIM
Nr. 18, datë 31.12.2014

PËR TË DREJTAT, DETYRAT,
MANDATIN, MËNYRËN E ZGJEDHJES
DHE FUNKSIONIMIT TË BORDEVE
NË SHKOLLAT PUBLIKE TË ARSIMIT
PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7/1 pika 4, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Bordi i shkollës ka për detyrë:
 - a) Të mbështesë procesin e zhvillimit të qasjes strategjike të shkollës;
 - b) Të marrë pjesë në procesin e emërimit dhe largimit nga puna të personelit mësimor dhe të drejtuesve të shkollës;
 - c) Të sigurojë përdorimin në mënyrë efektive të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukture;
 - ç) Të ofrojë këshilla dhe ndihmë për gjenerimin e të ardhurave shtesë, bazuar në aktivitetet dhe kapacitetet e shkollës;
 - d) Të nxisë bashkëpunimin me partnerë të tjerë, vendas e të huaj, që mund të kontribuojnë për veprimtarinë e shkollës.
2. Bordi i shkollës shqyrton dhe miraton:
 - a) Planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë së shkollës;
 - b) Planin financiar për fondet që shkolla merr nga buxheti i shtetit, fondet nga donatorë të huaj apo vendas, si dhe të ardhurat e realizuara nga vetë shkolla;
 - c) Planin vjetor të veprimtarisë së bordit.



3. Bordi i shkollës ka të drejtë të informohet për të gjitha aspektet e veprimtarisë së shkollës dhe shqyrton mbi baza tremujore realizimin e planit dhe parashikimin për periudhat e ardhshme.

4. Në raste të veçanta, bordi mund të komunikojë drejtpërdrejt me organet e qeverisjes vendore dhe qendrore, në lidhje me aspekte problematike të zhvillimit të veprimtarisë së shkollës.

5. Anëtarët e bordit e ushtrojnë detyrën për një afat prej 4 vjetësh, me të drejtë ripërtëritje deri në dy herë.

6. Në rast se një anëtar i bordit mungon pa arsye, në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të bordit gjatë një viti, kryetari i kërkon drejtorit të shkollës të nisë procedurën për zëvendësimin e tij.

7. Anëtarët e bordit nuk mund të dërgojnë një person tjetër për të marrë pjesë në mbledhjet e bordit.

8. Procedura për ngritjen e bordit kryhet nga drejtori i shkollës.

9. Bordi i shkollës është organ kolegjal dhe përbëhet nga:

a) Dy përfaqësues të sektorit privat që lidhen me profilet që ka shkolla;

b) Një përfaqësues i njësive arsimore vendore (DAR / ZA) që mbulon shkollën;

c) Një përfaqësues i këshillit të qarkut, që mbulon shkollën;

ç) Një përfaqësues i zyrës rajonale / vendore të punësimit, që mbulon shkollën;

d) Një përfaqësues i personelit mësimdhënës të shkollës;

dh) Një përfaqësues i nxënësve të shkollës.

10. Anëtarët e bordit zgjidhen si më poshtë:

a) Përfaqësuesit e sektorit privat zgjidhen nga sektori privat sipas profileve përkatëse. Përparësi kanë sektorët të cilët përfaqësojnë profilin që ka numrin më të madh të nxënësve në shkollë ose kanë pranuar numrin më të madh të praktikantëve nga shkolla, apo kanë financuar shkollën më shumë gjatë 2 viteve të fundit.

b) Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në pikat "b", "c" dhe "ç" të pikës 9, të këtij udhëzimi caktohen nga titullarët e institucioneve përkatëse.

c) Përfaqësuesi i personelit mësimdhënës zgjidhet me votim të fshehtë nga personeli

mësimdhënës i shkollës, me shumicë të thjeshtë.

ç) Përfaqësuesi i nxënësve zgjidhet nga qeveria e nxënësve.

11. Kryetari i bordit do të jetë një nga përfaqësuesit e sektorit privat, profili i të cilit ka numrin më të madh të nxënësve në shkollë.

12. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet i drejton përfaqësuesi tjetër i sektorit privat.

13. Kryetari e ushtron detyrën për një afat prej 4 vitesh, me të drejtë ripërtëritje.

14. Kryetari i bordit ka këto detyra:

a) Drejton veprimtarinë e bordit;

b) Ndan detyrat mes anëtarëve të bordit;

c) Drejton hartimin e planit vjetor të bordit, mbi bazën e detyrave që ka bordi;

ç) Fton sipas nevojave në mbledhjet e bordit drejtuesit e shkollës, mësues, përfaqësues të prindërve, nxënës etj.;

d) Komunikon sistematikisht me kryetarin e këshillit të prindërve.

15. Kryetari shkarkohet me shumicë të thjeshtë, me votim të fshehtë për moskryerjen e detyrave ose për mungesa në më shumë se dy mbledhje.

16. Votimi për shkarkimin e kryetarit zhvillohet me kërkesën e gjysmës së anëtarëve të bordit.

17. Sekretari i bordit është sekretari/sekretarja e shkollës ose një mësues i shkollës, i caktuar prej drejtorit.

18. Sekretari i bordit ka këto detyra:

a) Përgatit materialet për mbledhjet e bordit;

b) Mban procesverbalin e mbledhjeve të bordit;

c) Zbardh vendimet e bordit;

ç) Lajmëron anëtarët e bordit për mbledhjen e ardhshme;

d) Dorëzon në arkivin e shkollës procesverbalet e mbledhjeve, si dhe dokumentet e tjera.

19. Bordi mbledhet 4 herë në vit dhe domosdoshmërisht para fillimit të vitit shkollor, në mes të muajit shkurt dhe para përfundimit të vitit shkollor.

20. Bordi mund të mbledhet edhe jashtë radhe me kërkesë të drejtorit, të kryetarit apo të gjysmës së anëtarëve.

21. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur marrin pjesë të paktën 5 anëtarë. Në të kundërt mbledhja e bordit shtyhet për një datë sa më të afërt.



22. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet e zbardhura nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.

23. Vendimet që merr bordi pasqyrohen në librin e procesverbaleve, i cili mbahet nga sekretari i bordit.

24. Procesverbali i mbledhjes zbardhet dhe i dërgohet të gjithë anëtarëve të bordit, brenda një jave nga data e zhvillimit të mbledhjes përkatëse.

25. Anëtarët e bordit përfitojnë shpërblim vetëm për 4 mbledhje në vit nga të ardhurat e shkollës, nëse shkolla realizon të tilla.

26. Drejtori i shkollës ka për detyrë:

a) Të njohë bordin me aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me veprimtarinë e shkollës;

b) Të hartojë dhe të paraqesë dokumentet për të cilat bordi duhet të japë pëlqimin ose miratimin;

c) Të raportojë për çështjet e mbarëvajtjes së shkollës, sa herë kjo i kërkohet nga bordi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja Qendra e Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 133 lekë